

Angazhimet e NYC Test & Trace Corps ndaj njujorkezëve



Bëhuni pjesë e përpjekjeve të NYC Test & Trace Corps për të luftuar COVID-19: është për shëndetin tuaj dhe të njujorkezëve të tjerë! Për të gjithë njujorkezët që marrin pjesë në programin e NYC Test & Trace Corps, ne angazhohemi:

1. T'ju ofrojmë përfitim shërbimesh me respektin e dhembshurinë e duhur, pa gjykim, pavarësisht përkatësisë suaj racore, kombësisë, prejardhjes kombëtare, statusit të invalidit, orientimit seksual, identitetit gjinor apo shprehjes gjinore, statusit të imigrimit, moshës, statusit të sigurimit apo mundësisë për të paguar.
2. Mbrojeni privatësinë dhe mbajeni informacionin të sigurt. Çfarëdo informacioni që na jepni është konfidencial dhe i mbrojtur nga Kodi Shëndetësor i qytetit të Nju-Jorkut dhe ligje të tjera të qytetit dhe shtetit të Nju-Jorkut. Ne do ta ruajmë në mënyrë të sigurt dhe do të mund të përdoret vetëm nga personel i autorizuar. Databaza e NYC Test & Trace Corps nuk do të lidhet me ndonjë databazë autoritetesh ligjzbatuese.
3. T'ju trajtojmë me dinjitet, respekt dhe profesionalizëm.
4. Të mos ju pyesim për statusin e imigrimit tuajin apo të familjarëve tuaj.
5. T'ju ofrojmë shërbime përkthimi gjuhësor të përgjegjshme nga ana kulturore, duke përfshirë gjuhën amerikane të shenjave, nëse ju duhen.
6. T'ju ofrojmë shërbimet e NYC Test & Trace Corps pa pagesë. Testimi për COVID-19 dhe të folurit me një gjurmues kontaktesh nuk do të preken nga rregulli i barrës publike.
7. T'ju përshfijmë në diskutime të kryera me respekt me personelin e NYC Test & Trace Corps për shërbimet tona.
8. T'ju ofrojmë materiale për t'u veçuar në mënyrë të sigurt nga të tjerët nëse keni COVID-19 apo nëse jeni ekspozuar:
 - Në shtëpinë tuaj, duke shfrytëzuar burimet tona, si p.sh. dërgim falas të vakteve; ose
 - Në një dhomë falas hoteli apo ambient tjetër të cilin do t'ju organizojë personeli ynë. Në këtë hapësirë të përkohshme do t'ju jepen të gjitha vaktet, do të monitoroheni nga infermiere e mjekë të aftë 24/7, do të keni mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien, lidhje me internetin dhe telefonata lokale falas pa kufizime për t'u lidhur me të njerëzit tuaj të dashur.
9. T'u përgjigjemi pyetjeve tuaja për personelin tonë duke ju ofruar shërbime, si p.sh. personel nga hotelet apo organizatat me bazë komuniteti, duke përfshirë emrat, pozicionet dhe funksionet e tyre.
10. T'ju japim mundësinë të flisni me një supervisor apo avokatin e popullit. Roli i avokatit të popullit është të mbrojë të drejtat tuaja dhe t'u përgjigjet shqetësimeve që mund të keni në lidhje me NYC Test & Trace Corps. Nëse keni përjetuar apo vërejtur diskriminimin apo ngacmime, mund ta raportoni duke telefonuar 212-416-0197 ose duke vizituar nyc.gov/humanrights dhe duke përdorur formularin "Report Discrimination" (Raporto diskriminim).
11. Të sigurohemi që t'i kuptoni angazhimet e NYC Test & Trace Corps ndaj jush dhe të punojmë me ju për t'iu përgjigjur pyetjeve që mund të keni.

Çfarë mund të bëni për të luftuar COVID-19

TESTIM




Mësoni gjendjen tuaj. Merrni teste falas të COVID-19 dhe të antitropave.

GJURMIM



Përgjigjuni thirrjes së gjurmuesve tanë të kontakteve për të ndihmuar ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

PËRKUJDESJE



Veçohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjetër dhe merrni përkujdesje në hotel apo në shtëpi.

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe të sigurisë së informacionit tuaj personal dhe shëndetësor. I gjithë informacioni është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk do të pyesë për statusin e imigrimit të askujt.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

 **Test & Trace
Corps**